



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:269378

Datë: 26.11.2024

Numri i dokumentit: 06511857

**C-IV.-14-6689**

*Ankuesi:*

**M S** nga f.sh G K.Viti.

*Kundër:*

*E paditura:*

**N.SH “Agromorava”**, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.15 nëntor 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

**1.APROVOHET pjesërisht** si e bazuar ankesa dhe ndryshohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.GJI035-0275 i dt.02 tetor 2014.

**2.OBLIGOHET** e paditura AKP ti paguaj ankuesit M S në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës, shumën prej **200.00€**, kurse **REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumës së aprovuar dhe atë në shumë prej 1000.00€.

**3.** Shuma e aprovuar si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushet në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

**4.Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me dt.22 tetor 2014, ankuesi ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (më tej “Dhoma e Posaçme”) kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (më tutje AL) me nr. GJI035-0275 i dt.02 tetor 2014, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensim për

ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1,200.00€ nga N.SH “Agromorava” (në likuidim). Ankuesi në ankesë ka deklaruar se ka qenë punëtor i të paditurës deri në kohën kur AKP i ka dërguar letër pezullimin e dt.25 nëntor 2005, për shkak të shitjes së aseteve. Tutje ka shtuar se kërkesa për kompensim gjën mbështetje në nenin 40.1.6.2 të shtojcës së Ligjit nr.04/:-034 dhe i ka propozuar gjykatës që kërkesën e ankuesit ta aprovoj si të bazuar. Ankesës i ka bashkangjitur: Kopjen e vendimit të kundërshtuar, Kopje e procesverbalit nr.107 dt.14.04.2011, Kopjen e lajmit të publikuar në të përditshmen Koha Ditore për zjarrin e rënë në zyret e NSH-së, Kopjen e konfirmimit të lëshuar nga Policia e Kosovës nr.128 dt.20.04.2011.

Gjykata me anë të urdhrit të dt.10 maj 2024, kërkoj nga ankuesi që brenda afatit ligjor të bëjë dorëzimin e librezës së punës, kopjen e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, kopjen e listës së pagave si dhe provave tjera shtesë në mbështetje të pretendimeve ankimore. Me dt.20 maj 2024, ankuesi përmes parashtresës ka bërë dorëzimin e Letër konfirmimit nr.37495/24-OUT dt.17.05.2024, Regjistrimi i pagave të punëtorëve për muajin janar 2003, shkurt 2003, mars 2003, prill 2003, maj 2003, qershor 2003, korrik 2003, gusht 2003, shtator 2003, tetor 2003, Regjistrin e punëtorëve të cilët kanë qenë në rojë për muajin nëntor 2003, dhjetor 2003, Regjistri për muajin prill 2004, maj 2004, shtator 2004, tetor – nëntor 2004, dhjetor 2004, Regjistri – librit amzë, Dëshmi për librezën e punës dhe njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Kopja e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Me dt.13 gusht 2024 e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. Pala kundërshtare thekson se objekt është vetëm ligjshmëria e vendimit të AL. Ankuesi nuk ka treguar se cilin nen e ka shkelur AL-ja dhe se vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore dhe se nuk bazë për të shfuqizuar vendimin. E drejta e pretenduar e ankuesit është parashkruar konform nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. I ka propozuar gjykatës që ankesën ta refuzoj si të pa pranueshme dhe të pabazuar.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e ankuesit aprovohet pjesërisht si e bazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 71 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Ankuesi parashtroi kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit/Agjencia Kosovare e Privatizimit me dt.27 qershor 2013, ndërsa Autoriteti i Likuidimit e refuzoi kërkesën me dt.26 gusht 2013.

Gjykata konstaton se faktet e mëposhtme janë jokontestuese: Ankesa u regjistrua në Dhomën e Posaçme me dt.22 tetor 2014, ankuesi kishte punuar në NSH nga dt.03.05.1978 deri e dt.09.12.1978, prej dt.21.05.1979 deri me dt.31.12.1980, pastaj prej dt.01.01.1981 deri me dt.01.04.1990, si dhe prej dt.21.06.1999 deri me dt.25.11.2005.

Gjykata i konstaton si kontestuese çështjet e mëposhtme: Pranueshmëria e ankesës varet nga përgjigja në çështjen e parashtrimit të ankesës brenda afatit të paraparë me nenin 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr. 04/L-034) dhe nenit 74.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

### **Pranueshmëria**

Ankuesi, ka parashtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme me dt.22 tetor 2014 kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit nr. GJI035-0275 i dt.02 tetor 2014.

Po ashtu, gjykata gjen se është fakt i pa kontestuar se ankuesi ka punuar për NSH-në deri në marrje e njoftimit me dt.25 nëntor 2005, që nënkupton se Gjykata merr parasysh kur e llogarit periudhën e punësimit e cila e përcakton shumën e parave që duhet të paguhet si dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të punës, faktin se ankuesit - punëtorit marrëdhënia e punës nuk i është ndërprerë deri me marrjen e njoftimit të dt.25 nëntor 2005.

### **Ligji në fuqi**

Ligji për Ndërmarrjet (77/88) hyri në fuqi më 01.01.1989 dhe është ligj në fuqi në Kosovë.

Ligji për Ndërmarrjet i shfuqizon vetëm ato dispozita të Ligjit për Punën e Bashkuar që janë në kundërshtim me Ligjin për Ndërmarrjet.

Ligji për Ndërmarrjet, sidoqoftë, nuk u jep ndonjë përgjigje çështjeve që trajtohen me nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Për këtë arsye, neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar në asnjë mënyrë nuk është në kundërshtim me Ligjin për Ndërmarrjet.

Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24 parasheh se ligjet që janë miratuar nga Kuvendi i Jugosllavisë/Serbisë pas dt.22.03.1989 nuk janë ligje në fuqi në Kosovë.

Gjykata konstaton se Ligji për ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet dhe Ligji për Marrëdhëniet Themelore të Punës nuk janë ligje në fuqi, pasi që ato kanë hyrë në fuqi pas datës 22.03.1989.

Pasi që kërkesa është dorëzuar në AL brenda afatit, njoftimi për ndërprerje është i dt.25 nëntor 2005, rezulton se e drejta e ankuesit për dëmshpërblim është e afatshme, sikurse edhe me të njëjtën dëshmohet se ankuesit asnjëherë më parë nuk i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës. Në këtë kuptim gjykata duke u bazuar në deklaratat e pakontestueshme të dyja palëve, edhe pse AL

në mbrojtjen e paraqitur e kontestoj asnjëherë si ekzistencën ashtu edhe lartësinë e shumës të cilën e kërkoj ankuesi, gjykata gjeti se kërkesa e ankuesit është ligjore dhe asnjëherë nuk i ishte parashkruar, pasi që parashkrimi ishte ndërprerë me Njoftimin e dt.25 nëntor 2005.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Futja e NSH në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditorë në po atë procedurë. Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës i dt.25 nëntor 2005, dëshmon se ankuesi kishte ofruar shërbime për NSH-në deri me marrjen e këtij njoftimi, pra e ai kishte ofruar shërbime për NSH-në deri në kohën e likuidimit të saj.

Neni 12.2 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/ 27 ( si ligj në fuqi në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës) thotë që: “Në rastet e largimit të shkallës së gjerë nga puna zbatohen dispozitat e mëposhtme: (dh) punonjësi nuk mund të largohet nga puna derisa punëdhënësi të mos ia ketë paguar atij një dëmshpërblim të njëkohshëm. Dëmshpërblimi duhet t’i paguhet punonjësit në datën e shkëputjes së kontratës së punës sipas shkallës së mëposhtme:

- (i) prej 2 deri në 4 vjet stazh 1 pagë mujore;*
- (ii) prej 5 deri në 9 vjet stazh 2 paga mujore;*
- (iii) prej 10 deri në 19 vjet stazh 3 paga mujore;*
- (iv) prej 20 deri në 29 vjet stazh 4 paga mujore;*
- (v) 30 vjet stazh e më tepër 5 paga mujore;*

Gjykata e aprovoi shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u bazuar në Regjistrimi i pagave të punëtorëve për muajin janar 2003, shkurt 2003, mars 2003, prill 2003, maj 2003, qershor 2003, korrik 2003, gusht 2003, shtator 2003, tetor 2003, Regjistrin e punëtorëve të cilët kanë qenë në rojë për muajin nëntor 2003, dhjetor 2003, Regjistri për muajin prill 2004, maj 2004, shtator 2004, tetor 2004, nëntor 2004, dhjetor 2004, ku ankuesi pagën e kishte në shumë prej 100.00€, kurse nga Letër konfirmimi i lëshuar nga e paditura nr.37495/24-OUT dt.17.05.2024, vërtetohet se ankuesi kishte ofruar shërbime për NSH-në nga dt.03.05.1978 deri e dt.09.12.1978, pastaj prej dt.21.05.1979 deri me dt.31.12.1980, pastaj prej dt.01.01.1981 deri me dt.01.04.1990, si dhe prej dt.21.06.1999 deri me dt.25.11.2005, e që i bie se ka ofruar shërbime mbi 8 vite. Andaj, gjykata në bazë të dispozitave ligjore erdhi në përfundim se ankuesit i takojnë 2 paga e që i bie ( 2 x 100.00€=200.00€).

Andaj në bazë të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale. Ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore për ankesë me dt.03 maj 2024.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga data e pranimit. Ankesa duhet të parashtrohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtarja  
**Hajrie Shala**